



Проектот е финансиран од Европската Унија

Со критичко мислење до граѓани со медиумска умешност - КриТинк  
Mendim kritik për qytetarë me shkathtësi mediatike -KriThink  
Critical Thinking for Mediawise Citizens - CriThink

[CriThink.Mk](http://CriThink.Mk)



МЕТАМОРФОЗИС  
Фондација за интернет и општество



## Kultura mediale e nevojshme në luftën kundër informacionit të rremë

**Autor: Maja Terziova**

Kultura medial në një epokë të rrjedhës së informacionit është aftësia për të analizuar, vlerësuar dhe krijuar përmbajtje mediatike, por edhe për të vepruar se si të përdoret kjo përmbajtje në opinionin publik.

Finlanda kryeson listën e vendeve që mund të njohin dhe janë rezistente ndaj lajmeve të rreme, ndërsa vendet e tjera kopjojnë modelin e saj. Menjëherë pas saj janë, Holanda, Danimarka dhe Suedia, diku në mes Sllovenia, Spanja, Luksemburgu dhe Portugalia. Nga fund janë Mali i Zi, Bosnja, Shqipëria dhe Turqia, ndërsa vendi ynë është i fundit në këtë shkallë.

Katerina Topalova, një gazetare dhe redaktore e lajmeve në shërbimin publik, beson se sistemi arsimor finlandez është një nga më të mirët në botë, dhe se qeveria finlandeze në vitin 2014 ka filluar një fushatë kundër lajmeve të rreme të cilat kishin shkaktuar përçarjen e shiqërisë dhe ka trajnuar qytetarë, studentë, gazetarë dhe politikanët si t'i luftojnë ato. Sipas saj, kjo iniciativë i përgatiti qytetarët e të gjitha moshave për të përballuar botën komplekse dixhitale të ditës së sotme dhe të nesërme, dhe theksi më i madh u vu te nxënësit.



***Katerina Topalova, gazetare dhe redaktore e lajmeve në shërbimin publik***

"E gjitha fillon me arsimimin. Mendimi im është që media duhet të përfshihet gjithashtu në reformimin e sistemit arsimor. Gjatë gjithë histories, fuqinë e tyre asnjëri nuk ka guxuar ta nënvlerësoj dhe as ne nuk duhet ta bëjmë. Infodemia është një infeksion i epokës së re. Imuniteti fitohet vetëm përmes edukimit të mirë. "Kultura e mediave nuk është një copë letër, është një strategji e tërë që duhet të konsiderohet seriozisht dhe të zbatohet "- thotë ajo.



Проектот е финансиран од Европската Унија

Со критичко мислење до граѓани со медиумска умешност - КриТинк  
Mendim kritik për qytetarë me shkathtësi mediatike -KriThink  
Critical Thinking for Mediawise Citizens - CriThink

[CriThink.Mk](http://CriThink.Mk)



МЕТАМОРФОЗИС  
Фондација за интернет и општество



## Me mendimin kritik arrihet kulturë mediale më e madhe

Shfaqja e një lloji të ri të mediave, veçanërisht rrjeteve sociale, ka bërë të mundur që informacioni dhe mesazhet mediatike, përfshirë dezinformatat, të përhapen me shpejtësi.

Agjensia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale thotë se qytetarët mund të mbrohen nga lajmet e rreme vetëm nëse i përdorin mediat në mënyrë kritike dhe kurrë nuk i besojnë vetëm një burimi, por kontrollojnë çdo lajm në disa media të ndryshme. Ata këshillojnë të kontrollojnë faqet e internetit për verifikimin e fakteve që zbulojnë dezinformatat dhe publikojnë recenzie me informacione të sakta.

"Lexuesit gjithmonë duhet të kontrollojnë se kush është autori i informacionit dhe nëse nuk e dinë, ata duhet të kontrollojnë se çfarë gjërash tjera ai ka shkruar." Para se t'i besoni një fotografie ose një videoje, sigurohuni që ato janë të vërteta dhe me çfarë kanë të bëjnë. Ata duhet të shohin kur është publikuar për here të pare lajmi, sepse ata që përhapin lajme të rreme dinë të marrin informacione të vjetra dhe ta ribotojnë atë si të ri duke e vendosur atë në një kontekst tjetër, dhe kështu një deklaratë që është e vërtetë për shkak të kontekstit merr një kuptim të ri dhe të pavërtetë. Duhet të jenë të kujdesshëm kur shohin lajme, titulli i të cilit është sensacional, ka shumë pikëpyetje dhe pikëçuditëse (??? !!!) dhe përpiqet të ngjallë kuriozitet duke përdorur fraza si: "nuk do ta besoni këtë që ndodhi", thonë ata.

Docent Dr. Borce Arsov nga Instituti për gjuhën maqedonase "Krste Misirkov" thotë se baza e kulturës mediale është në mendimin kritik dhe analitik dhe arsimi është lidhja kryesore në shoqëri ku të rinjtë duhet të përqendrohen në të menduarit në mënyrë kritike.



*Docent Dr. Borce Arsov, Instituti për gjuhën maqedonase "Krste Misirkov"*



Проектот е финансиран од Европската Унија

Со критичко мислење до граѓани со медиумска умешност - КриТинк  
Mendim kritik për qytetarë me shkathtësi mediatike -KriThink  
Critical Thinking for Mediawise Citizens - CriThink

[CriThink.Mk](http://CriThink.Mk)



МЕТАМОРФОЗИС  
Фондација за интернет и општество



"Unë mendoj se fëmijët që nga mosha e hershme duhet të fillojnë të mësojnë për të marrë vendime racionale në atë që duhet të besojnë, dhe roli i arsimtarit dhe mësuesit, pra profesori është thelbësor. Për shembull, metoda e përdorimit të një libri shkollor në mësimdhënie ka avantazhet e saj, por të kuptuarit se teksti shkollor si i vetmi që përmban të vërtetën absolute mund të bëjë më shumë dëm sesa të mira për studentin"- shton ai .

Sipas Arsovit, mediat, veçanërisht ato elektronike, kanë fuqinë jo vetëm të informojnë, por edhe të ndërtojnë qëndrime dhe personalitete. Ai shtoi se një vendim kryesor për ndërtimin e vetëdijes kritike tek të rinjtë është roli i gazetarëve, të cilët duhet ta kuptojnë me përgjegjësi profesionin e tyre, duke marrë parasysh saktësinë, përpikmërinë dhe paanshmërinë e lajmeve dhe përdorimin e drejtë të gjuhës standarde të përdorur. Si gjuhëtar, duhet të përmend që njohja gjuhësore e gazetarëve në vendin tonë është në një nivel shumë të ulët, dhe madje edhe më zhgënjyese është fotografia në shtëpitë e mediave ku i kushtohet shumë pak, ose aspak vëmendje korrektësisë së shprehjes gjuhësore në njoftimet që bëjnë. Situata është veçanërisht e keqe në portalet e internetit, të cilat informojnë në kohë më reale ", shtoi ai.

## Qasja tradicionale e mësimdhënies si pengesë për gjeneratat e reja

Në vendin tonë është ende e rrënjosur thellë qasja tradicionale në të gjitha nivelet e arsimit, prandaj duhet të punojmë për reformimin e saj në interes të përfshirjes më të madhe të nxënësve në procesin e arsimit.

"Në fushën e arsimit të lartë në shumë fakultete, ende ekziston parimi që profesori flet dhe studentët dëgjojnë dhe marrin shënime. Ky është një parim që është plotësisht i pa zbatueshëm në mësimdhënien moderne, në një kohë kur teknologjia dixhitale dhe media e re ofrojnë një det me mundësi, shumë prej të cilave, për fat të keq, mbeten të papërdorura nga gjeneratat e tanishme, "tha Borce Arsov.

Sot në rrjetin social "Facebook" takojmë të njëjtin informacion të publikuar nga profile të ndryshme dhe nga media të ndryshme, në mënyra të ndryshme. Kjo shënon një qëndrim të ndryshëm të gazetarit ndaj lajmit, i cili le hapësirë për praninë e një dezinformimi shtesë ose informacione të pa verifikuar, me qëllim arritjen e një sensacionalizmi më të madh.

"Ekziston një problem tjetër, i cili është veçanërisht demotivues për të gjithë gazetarët, dhe kjo është se njerëzit nga të gjitha sferat e jetës dhe njerëzit me prejardhje të ndryshme po futen në këtë rol. Kështu , edhe ai që në mënyrë të ngathët ka bërë një artikull në një tabloid nga serbishtja në maqedonisht në emrin e tij, lehtësisht ngjit emrin gazetar "shton ai.



Проектот е финансиран од Европската Унија

Со критичко мислење до граѓани со медиумска умешност - КриТинк  
Mendim kritik për qytetarë me shkathtësi mediatike -KriThink  
Critical Thinking for Mediawise Citizens - CriThink

[CriThink.Mk](http://CriThink.Mk)



МЕТАМОРФОЗИС  
Фондација за интернет и општество



## Mediat në kontroll të opinionit publik

Media ndikon në publik dhe në formimin e opinionit publik. Mediat sociale publikojnë përmbajtje informuese dhe inkurajojnë bashkëveprimin.

Vesna Kostovska, një bashkëpunëtore e lartë në Institutin për gjuhën maqedonase “Krstе Misirkov”, thotë se mediat kontrollojnë mendimet tona dhe luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e sistemit tonë njohës, nga edukimi deri në indoktrinim.



***Vesna Kostovska, bashkëpunëtore e lartë në Institutin për gjuhën maqedonase "Krstе Misirkov"***

"Ideja që plasimi i rrëfimeve të rreme mund të ndikojë në mendimin dhe qëndrimin e dikujt pa kontrollin e palëve të treta është e frikshme. Në 20 vitet e fundit, lajmet e rreme të publikuara në faqet e rrejshme të internetit, janë shfaqur gjithashtu në portalet e mediave kryesore që kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në opinionin publik."

Sipas saj, prapa lajmeve të rreme janë individë ose grupe njerëzish që duan rrëfimet e tyre të arrijnë një audiencë të madhe dhe të ndikojnë në pikëpamjet e tyre politike, ideologjike ose ekonomike. Ajo thekson se Interneti është një tokë pjellore për përhapjen e lajmeve të rreme, sepse nuk ka filtra ose palë të treta që mund ti shikojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike këto lajme si të vërteta, objektive dhe të sakta, për këtë arsye kostoja e prodhimit të tyre është më e ulët se e ato të mediave të njohura dhe relevante.

"Të rinjtë marrin shumë informacion përmes mediave sociale dhe rrjeteve sociale si YouTube, Twitter, Instagram dhe Facebook. Këto platforma shpesh nuk citojnë burimin e informacionit dhe paraqesin të gjitha lajmet në një mënyrë sipërfaqësore, duke e bërë të pamundur të konkludohet nëse ato vijnë nga burime relevante. Në kontekstin e rrjeteve sociale, të rriturit gjithashtu përballen me të njëjtin problem, "shtoi Kostovska.



Проектот е финансиран од Европската Унија

Со критичко мислење до граѓани со медиумска умешност - КриТинк  
Mendim kritik për qytetarë me shkathtësi mediatike -KriThink  
Critical Thinking for Mediawise Citizens - CriThink

[CriThink.Mk](http://CriThink.Mk)



МЕТАМОРФОЗИС  
Фондација за интернет и општество



Në kohën kur media po ndikon çdo ditë në jetën tonë, kultura e mediave është lënë pas dore dukshëm në programet shkollore dhe proceset shkollore.

"Dhe është e nevojshme që qytetarët të jenë në gjendje të aplikojnë kulturën mediale , gjë që do t'u mundësojë atyre të merren me rreziqet, por edhe me përfitimet e mjedisit gjithnjë e më kompleks të mediave." Zhvillimi i kulturës mediale është një proces kompleks që kërkon investime afatgjata, por edhe një qasje të zhvilluar kombëtare, sistematike dhe strategjike. Situata është shumë alarmante dhe çdo vonesë në zhvillimin e vetëdijes për median,shkakton parashikime pesimiste për procesin e ndërtimit të një sistemi të civilizuar ", tha Vesna Kostovska.